



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **28.12.2023** me fillim në ora **10:10**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete **zt. Bajram Morina**.

Kryesuesi – Fillimisht përshëndetje për të gjithë, faleminderit për praninë tuaj. Përshëndetje për përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, zv. kryesuesin, për anëtarët e komitetit dhe gjithë të pranishmit. Ky është takimi i shtatë dhe i fundit për vitin 2023, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të komitetit për vitin 2024;
3. Informatë rreth vizitave të realizuara në shkollat e Komunës së Rahovecit;
4. Të ndryshme;

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me shumicë unanime procesverbali kalon.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës të komitetit për vitin 2024;

Kryesuesi – Atëherë shkojmë te objektivat: Miratimi i Planit të Punës për vitin 2024 dhe miratimi i Raportit të Punës për vitin 2023, periudha kohore janar 2024. Nën 2, përcjellja dhe shqyrtimi i rregullt i punës dhe veprimeve të organeve komunale, periudha kohore janar-dhjetor. Nën 3, vizitë vendbanimeve dhe shkollave ku jetojnë komunitetet joshumicë, periudha, mars – maj 2024. Nën 4, takime të ndryshme me drejtorët e drejtorive, qershor – shtator 2024. Nën 5, përdorimi i gjuhëve zyrtare në institucione publike, janar – dhjetor 2024. Nën 6, zbatimi i strategjisë dhe planit të veprimit të qeverisë për integrim të komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë e Kosovës 2021-2025, periudha kohore maj – shtator 2024. Nën 7, shqyrtimi i raporteve të organeve relevante komunale, janar – dhjetor 2024. Nën 8, përgatitja e Raportit të punës për vitin 2024 dhe Planit të Punës për vitin 2025, periudha kohore dhjetor 2024. Ky pra ishte Plani i Punës në vija të trasha. Nëse keni ndonjë sugjerim apo mendim tuajin, mund ta merrni fjalën.

Faton Ramadani - Përshëndetje për kryesuesi, anëtarët e komitetit dhe të pranishmit! Planin e Punës për vitin 2024 e kam lexuar me vëmendje. Mendoj që pika që i përmban plani mund të kontribuojnë në interes të komunitetit. Shpresojmë që plani të realizohet në formën e paraparë sepse është mjaft objektiv, gjithashtu shpresojmë që edhe ekzekutivi ta rrisë bashkëpunimin me ne. Faleminderit kryesues për punën e bërë.

Kryesuesi – Faleminderit zt. Ramadani! Atëherë nëse nuk ka dikush ndonjë gjë tjetër, e vendosim në votim Planin e Punës për vitin 2024! Kush është “për”?... Me shumicë unanime votohet Plani i Punës.

3. Informatë rreth vizitave të realizuara në shkollat e Komunës së Rahovecit;

Kryesuesi – Atëherë do t’ju informoj rreth vizitave që i kemi realizuar gjatë këtij muaji nëpër shkolla në të cilat janë duke vijuar mësimin nxënësit e komuniteteve, Rom, Ashkali, Egjiptianë, në bazë të Planit të Punës për vitin 2023 të Komitetit për Komunitete. Me datë 13 dhjetor 2023, kemi realizuar vizitë në ShFMU “Gëzim Hamza – Piktori”, ShFMU “Liria” në Fortesë dhe në ShFMU “Faik Konica” në Celinë. Pjesëmarrës në këto

vizita ishin edhe anëtarët e komitetit, drejtori i DKA-së, zt. Avni Morina, shefi i ZKK-së zt. Lendrit Qeli si dhe unë Bajram Morina në cilësinë e kryesuesit. Nga drejtorët e shkollave u informuam që nxënësit e komuniteteve janë të integruar plotësisht në klasat e komunitetit shumicë dhe janë duke vijuar rregullisht procesin mësimor. Jemi interesuar rreth vijueshmërisë së nxënësve, kushtet dhe sukseset e arritura. U jemi mirënjohës drejtorëve të shkollave për këtë përkushtim ndaj komunitetit pakicë.

4. Të ndryshme;

Faton Ramadani – Faleminderit kryesues! Po edhe unë kam qenë pjesë e komisionit që kemi dalur në terren për të parë më shumë rreth gjendjes që nxënësit e komuniteteve e kanë nëpër shkolla. Gjendja e shkollave të vizituara, në Celinë dhe Fortesë ishte relativisht e mirë, ndërsa në shkollën “Gëzim Hamza - Piktori” nuk ishte aq e kënaqshme për nga gjendja fizike. Mendoj që ekzekutivi duhet t’i bëjë disa investime në toaleta të këtyre shkollave. I falënderojmë drejtorët për mirëpritje.

Merisa Sharku – Përshëndetje për të gjithë. Megjithëse nuk kam qenë pjesë e këtyre vizitave, në përgjithësi e dimë që numri i nxënësve të komuniteteve është mjaft i vogël. Te Plani i Punës nuk e pashë që është detajuar ndonjë aktivitet që i inspiron nxënësit që t’i vijnë mësimet si lloj sensibilizimi.


Kryesuesi – Faleminderit Merisa. Po, sa i përket aktiviteteve që zhvillohen e që ndikojnë për të mirë në nxënësit e komunitetit joshumicë, ne e kemi qendrën mësimore në Ratkoc dhe besojmë që të aktivizohet shumë shpejt edhe qendra tjetër në qytet (në lagjen e epërme). Aktivizimi i qendrës mund të ndikojë në rritjen e interesimit. Lajm i mirë është që 13 nxënës të komunitetit joshumicë janë përfitues të bursave nga MASHT-i. Atëherë nëse edhe dikush nuk ka ndonjë gjë për të thënë, me kaq po e përfundojmë edhe mbledhjen e fundit për këtë vit. Ju dëshiroj suksese dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi: 10:45

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes;


Bajram Morina

